

Intervistë me kryetarin e ri të komunës Proptisht, z.Fuat Fero

Fero: Nuk dua të zhgënjej ata që ma besuan mua këtë post

“Sapo të bëj betimin përpara këshillit, do të filloj direkt nga puna. Njerëzit po presin punën time.”

E shtë ulur në karrigen e kryetarit të komunës vetëm para pak ditësh. E nisi si një dëshirë por ëndrra e tij u realizua. Sot e për katër vjet ai do të jetë kryetar i komunës Proptisht. Z. Fuat Fero para pak ditësh mori mandatin si kryetar i ri i komunës Proptisht, madje ka bërë edhe betimin para anëtarëve të Këshillit të ri. Në intervistën e mëposhtme Z. Fero flet për angazhimet e tij dhe mezi po pret që të fillojë nga puna. Hezitimi duket gjatë bisedës me të, nga fjalët dhe nga dëshira e madhe për të ndihmuar njerëzit e kësaj komune, sidomos ata në nevojë.



Së pari ju urojmë për mandatin e marrë, zoti kryetar! Gjatë anketimit të bërë a nuk menduat për një çast se e humbët mundësinë për të qenë në krye të kësaj komune?

- Faleminderit. Jo, aspak, unë isha më i qetë se kurrë, nuk e ndieja frikën e humbjes se e dija që përsëri unë do të isha fitimtari. Aq më tepër që kjo gjë u vërtetua tashmë me marrjen e mandatit tim të ri. (vijon ne faqen 3)

Anës Senës, anës Luvrit...

Katër ditë në Paris

Nga Flori SLATINA

T ë shkosh në Paris, mbetet një ëndërr edhe për ata që kanë qenë një herë më parë. Madje edhe tani që janë liberalizuar vizat dhe mundësitë janë për të gjithë, përsëri vajtja në Paris është një kënaqësi dhe lumturi më vete. Befasi ishte edhe për mua që, për herë të tretë, të shkoja edhe një herë në atë që, pse jo, quhet me të drejtë “kryeqyteti i botës”. Kësaj here mundësia erdhi nga Ambasada Franceze në Tiranë, në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve. Në muajin dhjetor 2010, në AQSHF erdhën dy specialistë nga instituti audio-vizual “INA” i Paris, për të verifikuar gjendjen e arkivit të filmit si dhe për të parë më nga afër punën, procesin dhe gjithë ecurinë e këtij institucioni të rëndësishëm të trashëgimisë sonë kombëtare. Pas disa muajsh erdhi raporti i hollësishëm, që për fat të mirë, është mjaft pozitiv dhe mbi të gjithë jo vetëm konstatonte por edhe sugjeronte dhe mundësonte zgjidhje të reja për të ardhmen. Në këtë kuadër u mundësua



KOMENTI POSTZGJEDHOR PËR ZGJEDHJET VENDORE TË 8 MAJIT 2011

Agai i beut dhe agallarët e rinj

Nga Koço PIHONI

Tregohet se dikur në një fshat të Korçës bëhej një dasmë. Në të nuk mungon të shkojë dhe agai i beut të fshatit. Për hir të së vërtetës, iu bë hatër i madh dhe ky nder nuk di në se iu bë nga halli apo nga malli për aganë?! Sebeçiu, i zoti i dasmës e fton të zinte vend Again në krye të tavolinës së miqve. E më pas e respektuan me të gjitha të mirat e nderet që i bëheshin një njeriu të radhës së tij. Urdhëron ti vënë përpara, pjesën e pasme të kofshës, bishtin e kokën e pjekur të dashit. Zotërisë iu bë rixha e madhe të bënte “dollarë” e mikut e si hëngri, piu



Sakrilegj në Shën Naum

Nga Kristaq NANUSHI

Ritet zakonore në zonën e Mokrës

Nga Zabit CUKU e Bashkim KRASTA

JETA NË BURG E SHKRIMTARIT MITRUSH KUTELI

“Në kampin e Vloçishtit, Kutelin e varrosën të gjallë”

KOMENTI POSTZGJEDHOR PËR ZGJEDHJET VENDORE TË 8 MAJIT 2011

Agai i beut dhe agallarët e rinj

Nga Koço PIHONI

Tregohet se dikur në një fshat të Korçës bëhej një dasmë. Në të nuk mungon të shkojë dhe agai i beut të fshatit. Për hir të së vërtetës, iu bë hatër i madh dhe ky nder nuk di në se iu bë nga halli apo nga malli për aganë?! Sebeçiu, i zoti i dasmës e fton të zinte vend Agai në krye të tavolinës së miqve. E më pas e respektuan me të gjitha të mirat e nderet që i bëheshin një njeriu të radhës së tij. Urdhëron ti vënë përpara, pjesën e pasme të kofshës, bishtin e kokën e pjekur të dashit. Zotërisë iu bë rixha e madhe të bënte “dollinë” e mikut e si hëngri, piu e këndo, shumë i kënaqur nga ky “ziafet”, Agai, më pas, kërkoi leje që të largohej dhe për edukatë pyet të pranishmit: “Mos kam harruar ndonjë adet pa bërë, më thoni ju lutem?” E dikush nga të pranishmit, për kujtesë, i thotë: “Aga, mos harosh të darovitësh “nusen”! Agai i prish në surrat e nuk mëngoi t’i përgjigjej atij rrethi burrash, që kishte përballë duke ju thënë: “Si nuk ju erdhi rëndë, si nuk ju erdhi turp të turpëroheni “xhanëm” si nuk gjykoni një cikë “qe Ti”, agajt i thamë të zerë qoshen këndin, nuk na i prishi, na dëgjoj, të hash kokën e dashit nuk na i prishi, bëj dollinë e mikut e bëri, këngën e muhabenë po se po. Po ta marrë vesh tani, të gjitha punët, Agai duhet t’i bëjë, xhanëm?” “Po si mendoni ju, o Aga, si mendoni ju, na thoni, çfarë duhet të bëjmë ne për ju?” “Darovitni nusen, kaq gjë të bëni!”, e u largua agai pa e bërë veten qeder e pa i bërë syri tërr! Si iku nga dasma, hipi kalin e me kamxhik kalit i ra, për të mos ja parë më bojën. Kjo histori bën pjesë nga e kaluara e këtij populli.

Po sot ka përsëri nga këta agallarë të rinj të Partisë!

Po ti vësh e shikosh me vëmendje këta agallarë të Partisë e Qeverisë sot, ndryshojnë shumë që në pamjen, veshjen e fjalët që nxjerrin nga goja.

Flasin ku e ku me fjalë të bukura, të mëdha, dhe kur vjen koha e bie fjala, ti dëgjoshtë flasin nëpër fushata zgjedhore, të habitet mëndja, kur dëgjon nga goja e tyre, të premtojnë për aftësitë çudibërëse të tyre po të votohet për ta, që ata të kenë pushtet. Garantojnë se ata do rrëzojnë edhe hënën, do përmirësojnë cilësinë e diellit, do sjellin koska e se po të thoni ju o popull, do ngjallim e të vdekurit nga varret! Po më pas?

Më pas, këta Agallarë të zgjedhur a të emëruar nga “beu”, besoj se nuk ndryshojnë shumë nga ata agallarë e asaj dasmës së fshatit. Për ta bërë sa më të thjeshtë e më konkrete, po rrëfej e marr si shembull të shëmbëllueshëm, këtu nga qyteti i bukur i Pogradecit. Dhe mos beso po deshe “në një kohë kur dëgjon të flitet për ndarje të pushteteve, shtet ligjor, luftë korruptsionit e aferave të pista, zbutje të varfërisë nëpërmjet



projektesh për hapjen e vendeve të reja punësimi e tjera e tjera. Fjalë “imzot, fjalë” Si është e vërteta, më këta agallarë sot?

Mos u çudit nëqoftëse vjen në Pogradec dhe do të dish kush është kryetari i Partisë Demokratike në Pogradec. Lehtësisht do mësosh se zotëria quhet Niko Duda. Vetëm kaq duhet t’ju mjaftojë se po e zgjate me pyetje të kësaj natyre e prish punën e djallos e kallkanos fare. Po përse? Se po pyete do mësosh se edhe Nën/prefekti i rrethit është ky që më parë ka qenë anëtar në Këshillin Bashkiak po, në Këshillin e Qarkut po, anëtar në tre a katër borde, në Ndërmarrjen e Ujësjellës-Kanalizimeve, në Alb-telekom, Ndërmarrjen Elektrike “Cez” besoj dhe tek Nd e Mirmbajtjes Rruga – Urrave po, po, po. Ka qenë se tani nuk ia lejon mandati i n/prefektit, por se ka fitjet dhe pushtetin dhe pjesën e tij edhe tani në këto borde. Por nuk mbaron këtu babëzia e këtyre agallarëve me suport e mbështetje nga oborri i “Beut” atje lart. Do të fillosh e punësohesh në doganë duhet të “votosh” tek ky Agai e lakejtë e caktuar të tij, do të fillosh punë në arsim, shëndetësi qoftë dhe sanitare duhet pa tjetër të “votosh” në kutinë e Agajt! se ndryshe “puthu me Milton”. Ju mbase u duket si çudi, po ja që kështu e përmban Kodi i këtyre agallarëve të zgjedhur për të vjedhur e rrjepur këtë millet dhe pa ju bërë “syri tërr” nga ligji.

Për ilustrim po ju rrëfej këtë ndodhi, pak kohë më parë një qytetar që kishte prejardhjen nga një familje e nderuar qytetare me kontribute qytetare të hershme, pjesëmarrje masive në LANÇLE më pas në ndërtime e vendit, por që si shpesh ndodhte i përballur me persekutime e burgun komunist.

E më pas ku qytetar kontribuoi duke qenë nga nismëtarë e P D për shumë vite pas 1990 por që e kish paguar këtë zell duke e larguar nga puna, megjithëse ishte autokton, më arsim të lartë, kryefamiljar e pa përlyer në afera e pislleqe, mundi të konkurrojë dhe të fitojë një vend punë! Më bindje se do

merrnin fund kusuret e tija, i shkon në pritje agajt dhe kërkon që ta ndihmonte, por iu duk çudi këtij fakiri, kur pa se Agai nuk ishte entuziast dhe e luajti të rëndin për këtë hall e preokupim, po si ka mundësi xhanëm, ky krekosej se ishte dashamirës dhe me zi priste t’i jepej mundësia për të dhënë ndikesën e tij? Po duket se ky qytetari kish “harruar” një diçka të vogël pa plotësuar, të “daroviste Nusen”. I zhgënjyer nga Agai, ky qytetar nuk nguroj t’i drejtohet me një Letër të hapur në medien e shkruar ku i drejtohet “Beut” të këtij agai lart, i cili kërkonte t’i drejtohej atij në Numrin e celularit... 420. ku i shpreh shqetësimin e tij si qytetar. dhe më pas i shkon përsëri këtij Agai në zyrë ku mori si përgjigje: “Kështu si e bëre ti unë duhet t’ju padisja në Gjykatë! Shumë mirë do bëni, çfarë të keqe ka. -Unë në gjykatë kam dosjen e babait të dënuar për agjitacion e propagandë, ju keni dosjen tuaj të pa gjykuar akoma, se vini nga trau i Doganës i paditur për Krim Ekonomik në shuma të mëdha? Kaq mjaftoj që ky zotëria t’i bjerë celularit e të njoftojë kryetarin e degës së brendëshme e të kërkojë “ndihmë” se ndodhet i “kërcënuar verbalisht”? Si ka mundësi të bësh një veprim të tillë, kur ti je dy metro burrë dhe kë dhe shoferin e bodigardin tuaj këtu në zyrë, si ka mundësi që dhe të drejtën e fjalës ta ndaloni? Kujt i shërben ky fashistizim? Kaq mjaftoj për të qëndruar në para burgim 12 orë pa asnjë ballafaqim e përgjigje, ky ishte një indinjim dhe zhgënjim i madh për atë qytetar e dëshmi e këthimit të sistemit në një regjim, satrap, ku shteti ligjor është kthyer në një nocion për këta Agallarë.

Ky qytetar gjeti zgjidhje, ju bë shpëtimtar atij e familjarëve të tija, Kryetari i Bashkisë, pa asnjë afinitet familjar apo militantizëm partiak?! Besoj se dhe këto rreshta dëshmojnë për shpagimin që qytetarët i treguan këtij Agai, këtij kuzari e shpates së kusarëv të tij! Po mirë qytetarët ja treguan vendin, ja bënë gjyqin më votën e tyre.

Rezultatet përfundimtare të

zgjedhjeve: Pjesmarja në votime nga 30000 – 100% votues 13417 - 45%

Për Kandidatin A. Shkëmbi 7580 – 56.5 % Për L. Topçin 5837 – 43, 5%

Vota këto përtej të majtës por sa për disa subjekte partiake të mara së bashku: d.m.th PS 28 % + PD 14 % + LSI 9 % + P R 6 % besoj se nuk do koment ky rezultat është shumë domethënëse që duhet të lexohet si një votë popullore e se kandidati fitues njëheras është dhe “deputeti” përfaqësues dëgjues e zgjidhës edhe i halleve e problemeve që kanë çdo familje qytetare edhe përtej bindjeve të tyre.

Po fshati, po fshatarët çfarë patën “xhanëm”? Ata nuk na i bënë asnjëherë fjalën dysh, deshën punë, Ata “Ga ne Na” aq sa ata, fshatarët që ishin mërziur të ruajtur dhëntë e dhitë e dëshironin të visheshin polica, të ruanin rendin e qetësinë në qytet, mjaftonte që ata të shisnin dhentë e dhitë e të “votonin” për Aganë dhe gjithçka ka shkuar si jo më mirë! Është e vërtetë se po të shkosh sot në fshat e të duash të investosh në blegtori se është gjynah i math, të vjen për të darë e për të zënë kokën me dorë kur shikon kasollet sot të boshatisura, pyllin kullotat të shkretuar pa blegtori, “baxhot” me inventarin e pajisje e duhura por pa njeri të dorëzojë qumësht, shko e shiko në Bishnicë e në Mokër e gjetiu.

Dhe këtë analizë bënte ky Agai i nderuar i tërë kësaj nahije tonë, besoj dhe ai me lot krokodili në sy do ketë thënë ky Aga: Po si nuk ju erdhi turp, të turpëroi që të gjitha “vota” nuk i kursyot për ne, dhe nuk u kujtuat të hidhni asnjë votë në kutitë e zgjedhjeve të 8 majit

2011 në asnjë nga tetë njësi zgjedhore të rrethit për PD e “beut” tonë?!!

Ja kështu i ndodhi këtij Agai tonë në këto zgjedhje vendore, ku në vend të votave ju ngeli kërraba për të shkuar vetë me dhitë e fshatit. Këta zotërinj janë të pajisur me pasaporta e Green card për t’u larguar në drejtim të paditur për të mos u vënë në fron para ligjit e për të mos u përgjigjur për ato “votat” e mara prej tyre, mbase kujtohen e na nderojnë përsëri duke ardhur për të kandiduar në zgjedhjet e radhës për kandidatura të përzgjedhur përjetësisht si ky zoti Duda, ky Aga tashmë për kaq e aq vite me radhë “Që the Ti zotrote” ka mbetur si i menderosur. Ka ardhur koha të përballen me shtetin ligjor, “vetëm” kaq gjë do t’ju kërkohet të bëjnë këtë radhë, këta Agallarë e Partisë në pushtet sot, ndryshe nga Agallarët e të shkuarës!

Mbase kujtohen e na nderojnë në zgjedhjet e tjera përsëri këtë malukatë, për t’u kandiduar në zgjedhjet e radhës si të përzgjedhur përjetësisht nga regjimi. Agai ynë sot është në hall të madh besoj, mendon si ti dalë përpara a shkojë kështu i menderosur para Beut atje lart, Si thua ti zotrote? Dhe ngushëllohet ky Agai jonë duke thënë: “E mo semos Beu vetë nuk ka dhe ai këtë hall që kam unë. Çuditërisht, se njohin, a se bëjnë vetën? Se dinë se janë bërë të pështirë e më të përbuzurit gjithandej e kanë filluar të mbajnë erë tashmë. Fryhet dhe ai Nastradin Beu atje lart duke e bërë të zezen e tija të bardhe, duke e ngrënë turpin me bukë pa të keq. Meshiro, o Zot!

GAZETA “MOKRA” ËSHTË E LIDHUR NGUSHTË ME JETËN E NJERËZVE

Nga Donika SHAHINI, SHBA

Më datën 1 qershor 2011 lexova në internet gazetën “Mokra” Nr. 7, qershor 2011, më tërhoqi shumë, u çmalla me vendlindjen time, Pogradec, Mokër. Por çmalla vazhdoi edhe më tej, mora direkt në telefon zotin Zenun FERRO. Më foli me shumë dashuri, më falenderoi shumë për telefonatën dhe më uroi shëndet dhe suksese paçi në SHBA, bashkë me familjen.

Gazeta, telefoni, interneti janë mjetet që ne njihemi me vendlindjen këtu në SHBA, duam të vijmë çdo vit por kjo është jashtë mundësisë tona financiare. Në Shqipëri, kemi lënë babanë, nënën, vëllezrit, motrat, miqtë, por s’keçi bën, kështu qënka jeta. Llotaria amerikane na respektoi duke na sjellë këtu në SHBA me banim, por vendlindja dhe njerëzit nuk harrohen kurrë.

E lexova me një frymë gazetën “Mokra” faleminderit që na informoni, me lajme kaq të mira, është një gazetë shumë e lidhur me jetën e njerëzve, ajo na afron informacion të saktë. Gazeta “Mokra” ka një traditë shumë të mirë komunikon mirë me lexuesin e vet. Unë kam folur me shumë njerëz që ndjekin “Mokrën” prej mbi 10 vjet, dhe të gjithë ndajnë të njëjtin mendim, që gazeta “Mokra”, është një gazetë shumë e afërt me njerëzit, sepse është trajtuar në vijimësinë e vërtetë dhe e sinqertë me ta.

Gazeta “Mokra”, nuk do të vdesë, ajo kurrë nuk do të vdesë, gjithmonë do të ketë kërkesa për këtë lloj gazete. Që do të shfaqet gjithmonë në internet është e vërtetë, në celulozë, po aq e vërtetë, por nuk përjashtojnë njëra tjetrën. Ajo çfarë 100 % do të vdesë janë gazetatat monomedia, këto po do të shuhen, sepse janë të bazuara vetëm në përcëimin e lajmit.

Intervistë me kryetarin e ri të komunës Proptisht, z.Fuat Fero

Fero: Nuk dua të zhgënjej ata që ma besuan mua këtë post

“Sapo të bëj betimin përpara këshillit, do të filloj direkt nga puna. Njerëzit po presin punën time.”

Është ulur në karrigen e kryetarit të komunës vetëm para pak ditësh. E nisi si një dëshirë por ëndrra e tij u realizua. Sot e për katër vjet ai do të jetë kryetar i komunës Proptisht. Z. Fuat Fero para pak ditësh mori mandatin si kryetar i ri i komunës Proptisht, madje ka bërë edhe betimin para anëtarëve të Këshillit të ri. Në intervistën e mëposhtme Z. Fero flet për angazhimet e tij dhe mezi po pret që të fillojë nga puna. Hezitimi duket gjatë bisedës me të, nga fjalët dhe nga dëshira e madhe për të ndihmuar njerëzit e kësaj

komune, sidomos ata në nevojë.

Së pari ju urojmë për mandatin e marrë, zoti kryetar! Gjatë anketimit të bërë a nuk menduat për një çast se e humbët mundësinë për të qenë në krye të kësaj komune?

- Faleminderit. Jo, aspak, unë isha më i qetë se kurrë, nuk e ndieja frikën e humbjes se e dija që përsëri unë do të isha fitimtari. Aq më tepër që kjo gjë u vërtetua tashmë me marrjen e mandatit tim të ri.

- Ju tashmë jeni kryetar i ri,

nga mendoni t'ia nisni? Në një prononcim të parin gjatë fushatës, keni thënë nga administrata, çdo të bëni me të?

- Tashmë ndodhem në këtë post, por ende s'kam filluar nga puna. Më duhet të mbledh këshillin dhe administratën aktuale. Duhet t'ia nis me po këta njerëz. Por, me të bërë betimin para tyre, asgjë s'më pengon të filloj direkt nga puna. Është e dukshme që njerëzit mezi po presin punën time. Nga do t'ia nis...nga administrata, kuadri, vendosja e një kuadri të ri, njerëz



Reportazh: Liqenorët festojnë së bashku çeljen e sezonit veror 2011!

Qyteti i Pogradecit në datën 21 qershor ishte organizatori mikpritësi i radhës i festës verore të shpallur prej 9 vitesh, Dita e Liqenit. Dita e çeljes së sezonit veror, apo Dita e Liqenit të Ohrit, është një festim që ka si kryeqëndër në rrotacion të tre qytetëve në të dy anët e bregut, Ohëri ishte mikpritësi në viti 2009. Struktura ishte organizator 2010 dhe Bashkia e Pogradecit e Zoti Artan Shkëmbi janë nikoqirët e çeljes të këtij sezoni veror 2011. Në këtë eveniment të rëndësishëm edhe për turizmin vendor ndodheshin të pranishëm të ardhur enkas në këtë aktivitet kryetari i bashkisë së qytetit të Ohrit, z. Aleksandër Petrofski, kryetari i bashkisë së qytetit të Strugës z. Ramiz Merko, kryetari i bashkisë së qytetit të Elbasanit, z. Qazim Sejdimi, të ftuar nga Bashkia e Korçës e qindra qytetarë të ardhur nga të dyja brigjet e liqenit të Ohrit. Në këtë ditë festive binte në sy mungesa e pranisë të zotërinjve nga Prefektura e Qarkut Korçë, si dhe mungesa e përfaqësuesve nga Ministria e Turizmit, Rinisë e Sporteve?! Imazh i keq i bashkëpunimit të Pushtetit Qendror me Pushtetin e zgjedhur Vendor.

Sheshi i qytetit ishte zbukuruar me flamuj e banderola, ambienti festiv mbështetej edhe nga formacionet e grupit të këngës qytetare “Nostalgjia” dhe formacioni frymor i bandës frymore të qytetit si dhe grupe të rinjsh e të reja me veshje etnografike e valltarë nga e gjithë treva jonë, të cilët debutuan me shumë sukses. Në këtë ditë festive, sheshi qendror gumëzhinte nga vizitorët që frekuentonin njësitë e shitjes në këtë panair si njësitë e libra shitjes, prodhime prej balte, qëndisima, apo prodhime pasticerie etj. Në orën 12:00 në sheshin para pallatit të kulturës “Lasgush Poradeci”, në prani të qindra qytetarëve, medieve qendrore e lokale, u shpall çelja zyrtare e Ditës

së Liqenit. Në fjalën e tij, Kryetari i Bashkisë të Qytetit Ohrit, zoti Aleksandër Petrofski i cili në fjalën e tij, përshëndeti banorët dhe z. Shkëmbi për këtë organizim tashmë të bërë praktikë në të tre qytetet e liqenit, përgëzoi për mikpritjen, punët e ndryshimet e dukshme të qytetit dhe uroj për punë të mbarë e suksese në këtë mandate të ri qeverisës. Vlerësoj punën e bërë me kolektorin e ujërave dhe ndikimin e tij në pastërtinë e liqenit të Ohrit, kësaj pasuri të përbashkët i cili është në mbrojtje nga UNESCO. Më pas fjalën e mori kryetari i Bashkisë së qytetit të Strugës, z. Ramiz Merko në fjalën e tij ai ndër të tjera vlerësoj këtë bashkëpunim të frytshëm disaveçar, mbështeti fjalën e Petrofskit për dobinë e një linje ujore Tragetit Pogradec -Ohër - Strugë si dhe për një linjë hekurudhore e cila do bëjë të mundur lidhjen midis dy vendeve Lin - Radozhinë - Kërçovë. Më pas Zoti Shkëmbi në fjalën e tij, përshëndeti të gjithë të pranishmit dhe

veçmas miqtë e përtej bregut për seriozitetin mirëkuptimin dhe bashkëpunimin e frytshëm që këta tre Kryebashkiakë kanë pasur gjatë këtyre viteve në të mirën e mbarëvajtjen e lidhjeve dypaleshe si pushtete vendorë. Përmendi lidhjet e hershme midis popujve të dy anëve të liqenit si dhe lidhjet martesore, këngët, zakone e doko të përbashkëta Zoti Shkëmbi vlerësoj Bashkëpunimin Rajonal si “Çelësin” e suksesit të përbashkët në fushën e turizmit e fusha të tjera, gjithashtu ai vuri në dukje dhe kritikoj e kërkoj angazhimin e vullnetin e duhur nga të dyja qeveritë, mbasi ekzistojnë marrëveshjet të firmosura prej 4-5 vjet të shkuara.

Më pas programi i kësaj dite kishite aktivitetet sportive Ringjalljen, në gara ciklistike, gara në sportin ujqor të kanotazhit dhe ne orët e mbrëmjes vizitë në GAF, Ekspozitë Fotografike e programe të ndryshme artistike të cilat e gjallëruan së tepërmi këtë festim tashmë shumë qytetar për këta qytete.

K. Pihoni

PËRFUNDON UNAZA E KOMUNËS SË RRAJCËS

Ka përfunduar brenda afatit të përcaktuar një tjetër rrugë e asfaltuar në Komunën e Rrajcës, në rrethin e Librazhdit, rreth 45 kilometra larg Elbasanit. Punimet, të cilat nisën në fillim të këtij viti, me një fond prej 55 milionë lekësh të dhëna nga qeveria shqiptare, bënë të mundur rikonstruksionin e 2.1 km rrugë, ku përfshihet edhe unaza e fshatit me të njejtin emër. Inxhinieri zbatues i projektit, Fadil Dezhgiu, tha se “projekti i cili ka përfunduar përpara afatit kohor parashikonte edhe ndërtimin e unazës me asfalt gjatë gjithë gjatësisë së saj si edhe të kanalizimeve të ujrave të zeza dhe të bardha, të cilat tashmë kanë përfunduar”. Kjo është unaza e parë në të gjitha komunat e nënprefekturës së Librazhdit. Me ndër-timin e kësaj unaze tashmë banorët e fshatit Rrajcë do të qarkullojnë lehtësisht nga fshati në drejtim të komunës, pasi vetëm një vit më parë qarkullimi në këtë aks rrugor kryhej me vështirësi për shkak të gropave të mëdha dhe baltës.

të arsimuar që do t'i përkasin postit që do të zënë, të ndershëm dhe punëtorë. Do t'ju bëj atyre të ditur rregullat dhe do t'ju theksoj se korrektesia dhe puna do të jetë reciproke. Gjithashtu, kam menduar propozimin tuaj të vlefshëm, për të hedhur në zbatim një ligj për median. Duhet vërtet që me punën që do të kryejmë, duhet të jemi në koherencë me median dhe më të hapur ndaj saj, pasi ajo është një mbështetëse e kritikuese mjaft e vlefshme për punën tonë.

- Domethënë do të bëni zëvendësime, do të vijnë njerëz të rinj, por mbi bazën e çfarë kritere do t'i përzgjidhni ata?

- Siç e përmenda edhe më lart, më duhen njerëz punëtorë, por edhe të arsimuar. Ata që kanë përvojë pune dhe ata që e dinë mirë punën e tyre. Unë jam një njeri që e vlerësoj punën dhe mundin dhe njerëzit që dua të punojnë me mua duhet të jenë korrektë në atë që marrin për sipër për të bërë. Individët që do të jenë pjesë e kuadrit, pothuajse do të mbulojnë çdo fshat të kësaj komune. Përveç punëve në gjendjen civile, banorët e fshatrave Rrodokal, Homezh etj., s'kanë përse të lodhen më, pasi punonjësi përkatës i kësaj komune, për çfarëdo lloj problem do të shkojë në këto fshatra, duke lënë një ditë dhe një orar të caktuar për tu mbledhur. Tjetër gjë, anëtarët e kuadrit do t'i prezantoj në fshatrat përkatës, që dhe ata të dinë se ku të drejtohen dhe kujt t'i drejtohen.

- Cfarë ndryshimi keni në mendje tani për tani, një ndryshim që duhet bërë patjetër?

- Shumë punë janë imediate në këtë komunë, pasi po të hedhësh një vështrim ka vend

për shumë punë, por ajo ç'ka është më e rëndësishme dhe më me urgjencë për të bërë, është mundësia dhe t'ju vij në ndihmë familjeve në nevojë të kësaj komune. Kam marrë disa të dhëna rreth tyre dhe ndihma ime e parë do të jetë për ta. Besoj se askush nuk do më gjykojë për këtë gjë, kur të mësojnë se kush familje do të ndihmohet. Do të ketë vend për të gjithë, do të ketë ndihmë për të gjithë, do të menjohet për të gjithë.

- Po përse i përket mjedisit, apo diçkaje që duket, që bie vërtet në sy, pasi boll dëgjuam vetëm propogandë, do donim të shihnim diçka konkrete, diçka reale, çfarë do të bëni?

- Sigurisht që do t'i hyj punës sapo të jem vërtet në atë post dhe në atë zyrë. Po patjetër që ambienti ka nevojë për shumë ndryshim dhe ky ndryshim do të fillojë, do të bëj gjithçka kam në dorë për të mirën e kësaj komune, por kjo gjë varet dhe nga buxheti që do t'i ofrohet komunës sonë. Por me këtë gjë do të njihemi në mbledhjen e zhvilluar me këshillin.

Kur do të jetë kjo mbledhje? A nuk mendoni se duhet të nxitoni disa, pasi janë shumë punë që po ju presin, sidomos njerëzit për të shikuar ndryshimin që ju i keni premtuar se do i sillni kësaj komune?

- Mbledhja do të realizohet së shpejti se dhe unë e kam menduar që më presin shumë punë dhe nuk dua të zhgënjej ata njerëz që më besuan mua këtë post. Ndryshimi do të jetë i dukshëm. Këtij vendi i duhet një gjë e tillë, duke parë gjendjen në të cilën ndodhet.

Ju falënderoj për intervistën dhe ju uroj punë të mbarë!

Intervistoi: Bora SHAHINI

Anës Senës, anës Luvrit...

Katër ditë në Paris

Nga Flori SLATINA

Të shkosh në Paris, mbetet një ëndërr edhe për ata që kanë qenë një herë më parë. Madje edhe tani që janë liberalizuar vizat dhe mundësitë janë për të gjithë, përsëri vajta në Paris është një kënaqësi dhe lumturi më vete. Befasi ishte edhe për mua që, për herë të tretë, të shkoja edhe një herë në atë që, pse jo, quhet me të drejtë "kryeqyteti i botës". Kësaj here mundësia erdhi nga Ambasada Franceze në Tiranë, në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve. Në muajin dhjetor 2010, në AQSHF erdhën dy specialistë nga instituti audio-vizual "INA" i Paris, për të verifikuar gjendjen e arkivit të filmit si dhe për të parë më nga afër punën, procesin dhe gjithë ecurinë e këtij institucioni të rëndësishëm të trashëgimisë sonë kombëtare. Pas disa muajsh erdhi raporti i hollësishëm, që për fat të mirë, është mjaft pozitiv dhe mbi të gjithë jo vetëm konstatonte por edhe sugjeronte dhe mundësonte zgjidhje të reja për të ardhmen. Në këtë kuadër u mundësua nga INA edhe një vizitë e specialistëve të këtij institucioni për të parë dhe për të përfutur nga përvoja dhe procesi i këtij arkivi, në një seminar dyditor pranë institutit të rëndësishëm të filmit dhe televizionit. Më hollësisht për këtë institut do të flas më vonë.

Kështu, falë këtij bashkëpunimi të shkëlqyer mes Ambasadës Franceze, dhe veçanërisht z. Raymond Chaffort dhe znj. Azra Hasanovic, atashe kulturor e cila ka disa javë që e ka lënë Tiranën për Brukselin, si dhe Ministrisë së Kulturës e veçanërisht angazhimit dhe përkushtimit maksimal të zv./ministres nj. Zana Turku, nga 9-10 u krye ky specializim i rëndësishëm dhe dobiprurës.

Sapo u caktua data, më parë se unë përfytyrimi im kapërceu kufijtë. Më erdhën në mendje përsëri ato imazhe që i kisha parë, ato rrugë, apo banesa karakteristike, si dhe metroja e famshme e Parisit. Emra objektesh, rrugë, ngjarje, personalitete të shquara, të gjitha këto me vlera unikale në botë. Tjetër është ta dish, tjetër është ta dëgjosh e tjetër ta shohësh e ta prekësh vetë. Edhe pse hera e tretë, emocione të veçanta të kapin, kur e beson se do shkosh përsëri. Këtë magji ta jep Parisi, që edhe pse e ke parë, përsëri ke dëshirë ta shohësh, nuk ngopesh me të, një dashuri që nuk mbaron kurrë.

Nisja bëhet më datën 8 qershor. Ditë e bukur në Rinas. Është pak nxehtë, temperatura në Tiranë mbi 30 gradë. Mesditë. Teksa bëjmë check-in, kontrollin policor, futemi në pjesën e pritjes. Përballesh në qiellin e pastër ulen e ngrihen avionë të kompanive e vendeve të ndryshme. Në pistë, pak më larg, duket një avion i madh prej rreth 130 vendesh i kompanisë prestigjioze "Lufthansa". Për momentin kjo kompani ofronte bileta me çmime shumë të favorshme, por mbi të gjitha ajo ofronte kushte shumë më të mira fluturimi. Sapo shkelim në avionin, më erdhi ndër mend hera e parë kur kam hipur në një avion. Për fat të keq, vonë, shumë vonë, më 2001 dhe kjo ka ndodhur në Podgoricë, në një avion të vogël të kompanisë jugosllave "Jat", në një udhëtim drejt Beogradit. Frika dhe emocionet ia linin vendin njëra-tjetrës. Ishte një vizitë pune mundësuar nga Institutit i Medies, me 10 gazetarë të ndryshëm të shtypit shqiptar. Që nga ajo kohë, prej mëse një dekade, kam pasur rastin të fluturoj edhe shumë herë të tjera e tashmë, drejt Parisit, në verë, jo si dy herët e para, në dhjetor.

Avion merr vrull, shkëputet nga pista dhe shumë shpejt poshtë nesh shfaqet kaosi i bane-save dhe trokave, pa asnjë rregull e sistem, i krijuar këto dy dekadat e fundit. Pas pak, dalëngadalë, shfaqet vija bregdetare dhe më pas avioni kalon mbi retë. E kotë të lodhesh se



mos dallon më shumë. Rehatohemi në ndenjëset për të lexuar shtypin, gazetat e ditës si dhe disa gazeta në gjuhën gjermane që i gjejmë në avion, thjesht sa i shfletojmë për të kuptuar ndonjë fjalë e për të shtyrë kohën. Poshtë nesh, herë pas here shfaqen maja maresh, pjesë detesh, qytete nën re. Drejt Myhinut ku është ndalesa jonë e parë, jemi pak me vonesë. Megjithatë, duke besuar në korrektesinë gjermane, shpresojmë se do të kapim avionin tjetër drejt Parisit. Dhe ashtu është. Aty na presin vetëm ne. Jemi katër vetë drejt Parisit. Një punonjës i aeroportit, apo i "Lufthansës", kujdeset deri në hipjen tonë në avioni tjetër, i cili na priste në pistë, gati për fluturim.

Pas më shumë se një ore, i afrohemi Parisit, aeroportit "Charle De Gaul", një nga më të mëdhenjtë e botës. Poshtë nesh shfaqet Parisi madhështor, rrethinat me një rregullsi të habitshme, gjelbërim, rrugë e ndërtime të reja, sikur të kishim të bënim me një maket të madh. Parisi, edhe nga ajri është i gjatë, i madh, i pafund. Avioni çan retë e bardha pulpore, sikur të jetë lodhur nga prania e tyre dhe ulet ngadalë në pistën e freskët të aeroportit. Këtu temperatura nuk është më shumë se 15 gradë dhe kontakti parë me ajrin na tremb. Ne kishim ardhur me rroba me krahë të shkurtër, por këtu ishte freskët, për të mos thënë ftohtë.

Në aeroport na pret një taksitë e kompanisë "Avis". Shoferi na beson, edhe pse në fillim heziton, pastaj qesh e thotë shqip: "E dija që do të ishit shqiptarë! E pashë nga emri". U befasuam. Ai ishte shqiptar nga Gjilani i Kosovës dhe punonte e jetonte në Paris prej mëse 12 vjetësh. Punonte pranë kësaj kompanie dhe herë pas here kishte pasur raste të priste e përcillte edhe yje të kinematografisë botërore, për të cilët na tregonte me krenari. "Një herë mendova të mos flas shqip, por pastaj u pendova", tha dhe na ftoi miqësisht drejt makinës së tij për të lënë aeroportin e madh. Në autostradë nuk kishte edhe aq pengesa, megjithatë trafikun dukej paksa i rënduar për shkak të punimeve diku në një cep të saj. Gjithçka lëviz qetë, butë dhe ëmbël. Nuk të nervozojnë aspak, përkundrazi seç ndjen një farë kënaqësie kur shikon këtë lumë të gjatë makinash t'i lënë vendin njëra-tjetrës në gjarpërimin e tyre drejt Parisit.

Nuk e ndien kur hyn në Paris, thuhet gjatë gjithë kohës të duket sikur je aty. Pasi kemi lënë pas stadiumin e madh "Stade de France", ndërtesa të mëdha të kompanive të ndryshme, fillon dalëngadalë të ndihet rregullsi dhe harmonia në rrugë e banesa të një tipi. Rrugë,

shëtitore, trafik i dendur, pallate të hirta, semaforë... Makinat duken sikur ecin si me telekomandë, të gjitha të heshtura, pa bori, pa zhurmë, mbi të gjitha pa asnjë njollë tymi nga pas. Parisi është si i akullt, çdo gjë duket sikur shkëlqen, ndrin një bukuri e veçantë deri në marramendje.

Si ndahemi me taksistin gjakovar, rehatohemi në hotel, një hotel i vogël por komod në Montreuil. Nuk mendojmë të qëndrojmë gjatë aty. Më mirë të dalim, kemi akoma kohë për të parë Parisin në buzëmbremje. Ora është 6 dhe do edhe shumë kohë që dielli të perëndojë. Do marrim metronë, fillimisht drejt katedrales Notre Damme, pasi edhe hoteli ynë është aty pranë tre - katër stacione metroje më tutje. Sapo futemi në metro një erë karakteristike të shoqëron gjatë gjithë kohës. Të gjithë nxitojnë, të duket sikur të merren mendtë nga ritmi. Sytë sa te harta, aq te njerëzit që ecin me nxitim. Si marrim drejtimin e duhur, zbrisim pranë Notre Damme, aty është "stacioni" ynë i parë, nga këtu nis udhëtimi dhe tregimi për Parisin. Kjo nuk ka ndonjë rëndësi por thjesht për shkaqe objektive, pasi që aty fillojmë përshkrimin e një prej qyteteve më të mëdha të botës, aty ku fluturojnë ëndrrat e miliona vetëve në botë.

Në rrugicat që të nxjerrin përbri katedrales së famshme gjithçka është e bukur. Rreth e rrotull suvenire, dyqane të shumta, objekte të famshme për t'u parë, aq sa nuk të ngopet syri. Ndodhemi në Lagjen Latien, më e vjetra e Parisit, më historikja, bërthama e tij. Sena që rrjedh përmes e ndan më dysh. Sena ndahet nga dy ishuj që lidhen mes tyre me një urë metalike. Ishulli u ndërtua nga Jul Qezari në vitin 52 para Krishtit. Mes godinave të shumta ajo që bien në sy për madhësinë e saj është Notre Damme, e ndërtuar në shekullin 12-të, në stilin gotik. Ndërtimi i saj filloi në vitin 1163 dhe mbaroi pas 160 vjetësh, më 1345. Tepër zotëruese nga madhështia e saj, katedralja në mijëra e mijëra vepra arti që e përbejnë atë, mes dritave e parmakëve të shumtë të duket sikur shfaqet Kuazimode e diku në cep edhe zeshkama Esmeralda, emrin e së cilës e mban një lokal aty afër. Madhështia e saj shkon përbri me madhësinë e Hygoit, i cili e ktheu atë në një mit, i dha të tjera përmasa që frymëzoi me mijëra artistë në mbarë botën. Në atë orë të mbrëmjes katedralja ishte mbyllur por nga jashtë ka turistë të shumtë të të gjitha racave, thuhet nga e gjithë bota. Bëjnë fotografi, qëndrojnë aty disa çaste, sikur duan të ngopen me të, e pastaj nisen në këmbë drejt Pont Neuf, që në fakt kjo "Urë e Re" ka një

moshë jo pak por mëse 400-vjeçare dhe ajo që ka të re vetëm emrin e saj. Kjo zonë ka a shumë vlera, e histori saqë nuk e përshkruan dot në pak rreshta. Aty pranë ndodhet edhe bashkia e Parisit si dhe ndërtesa të tjera të vjetra e të bukura. Menjëherë pas Pont Neuf, shfaqet një masiv ndërtesash po aq të bukura e madhështore si dhe të tjerat. Rreth e rrotull një park e një hapësirë e veçantë për këmbësorët e shumtë, Luvri. Kur e shikon për herë të parë, si çdo gjë në Paris, edhe Luvri të le pa mend. Një ndërtesë e madhe, e gjatë e pandërprerë, në formë patkoi, ku çdo shekull ka bërë shtesat e veta e që nuk duket aspak ndërhyrja. Luvri është një qytet kështjellë, ku ruhet një pjesë nga pasuria më e madhe e artit pamor botëror.

Fortesë që prej vitit 1204, më pas Luvri ka shërbyer si seli e mbretërve më të famshëm të Francës, dhe do të duhej Revolucioni i 1789-ës, për ta kthyer përfundimisht në muze. Objekt madhështor që të ngjall admirim dhe habi, Luvri është më i madhi dhe më i famshmi muze i arteve figurative në botë. Përherë, si në dimër, në vetë, në mëngjes e në mbrëmje, Luvri ka shumë vizitorë, sa jashtë edhe brenda. Pasi hymë nga porta lindore, në hapësirën e brendshme shfaqen masive të tëra ndërtesash të zbukuruara me statuja të shumta, brenda së cilave janë sallat ku ekspozohen objektet e rralla të trashëgimisë botërore. Në hyrje të Luvrit është piramida e xhamtë, pranë një shatërvani freskues me mermer të zi. Ajo është hyrja moderne e Luvrit të madh e bashkëkohor. Piramidës së madhe i bëjnë shoqëri tre piramida më të vogla. Sapo zbret shkallët e reja, në një sipërfaqe të madhe rreth e rrotull, shfaqen dyqanet e suvenireve, bari dhe restoranti i madh me mbi 300 vende, biletaritë automatike, informacioni dhe më pas galeritë e shumta që presin vizitorë njëri pas tjetrit. Thuhet se Luvrin e vizitojnë mbi 4-5 milionë njerëz në vit. Shumë prej tyre që e kanë parë njëherë dëshirojnë të kthehen përsëri. As Parisi e as Luvri nuk mbarojnë kurrë. Nuk ke kohë fizike të shikosh të gjitha. Duhet ditë, të tëra. Janë mbi 12 mijë objekte të ekspozuara, ndërsa fondi ka afro 500 mijë vepra, të cilat ekspozohen herë pas here në salla të veçanta, me tematika të ndryshme. Dy orë nuk mjaftojnë për të kaluar flesh nga një sallë në tjetrën e të duket se gjithçka përmblidhet vetëm tek një krijim, Mona Liza. Po pate parë Mona Lizën, ke parë Luvrin dhe të gjithë atje nxitojnë, të gjithë duan të bëjnë një foto e të kenë një kujtim pranë portretit të Mona Lizës së mbroritur me një xham të madh. Pasi ke parë Mona Lizën, pastaj, i ngopur, fillon e kthehesh pas, për të shkuar më tej. Parisi nuk është vetëm Luvri. Jashtë ka të tjera mrekulli që të presin...

Pranë Luvrit, shfaqet në cep të tij rruga "Rivoli", e njohur edhe për dy ngjarje shqiptare. E para ka të bëjë me hotel "Kontinentin", ku Avni Rustemi vrau më 81 vjet më parë, më 13 qershor 1920, Esat Pashë Toptanin. Ndërsa në një tjetër hotel, që ndodhet në rrugën "Rivoli", "Hotel de Louvre", bujti delagacioni shqiptar në Konferencën e Paqes në 1946 në Paris. Në fakt në Paris ka shumë shqiptarë, nga emigrantët e vjetër të para Luftës apo edhe nga ata që i shpëtuan regjimit komunist, por edhe shumë të rinj, të ardhur pas viteve 90-të, e deri tek emra të shquar si shkrimtari ynë i madh Ismail Kadare, sopranoja me famë botërore Inva Mula, koreografi Angelin Prelocaj, regjisorja Liri Begeja, etj. etj. Ky komunitet nuk është i organizuar, dhe vetëm me rastin e Festës Kombëtare mund të takohesh me shumë prej tyre në pritjen që organizon Ambasada jonë në Paris, që aktualisht drejtohet nga shkrimtari i mirënjohur Ylljet Aliçkaj. Pasi dalim nga porta perëndimore e Luvrit, shfaqet kopshti dhe më pas Pallati Tyleri, seli mbretërishe e perandorësh. Kopshti është i mbushur me statuja nga më të vjetrat tek ato më modernet, plot karrige e stola për vizitorët e shumtë që ulen për t'u çlodhur. Pak më tutje

vjen sheshi Concord, aty ku i prenë kokën Luigjit të VXi, një shesh i mbushur me ngjarje, me përkujtime, festa e parakalime. Në mes të tij gjendet një obelisk i madh, i rrethuar nga statuja e përmendore plot madhësi. Obeliskun e solli perandori Bonoparti nga Egjipti. Thonë se u desh të ndërtohej enkas një anije e posaçme që ai obelisk të vinte i plotë e që të mos shkatërrohej rrugës, i ndarë në pjesë. Pallatet e tjera përreth janë po aq tipikë e madhështore sa të tjerët dhe herë pas here aty organizohen festa e veprimtari kombëtare e ndërkombëtare.

Në fund të kësaj rruge fillon Shanz Elize, bulevardi më i famshëm e ndër më të bukurit në botë. I gjatë, i gjerë, i shtruar me rrasa të vogla guri, ai shkon deri tek sheshi i Harkut të Triumfit. Në të dy anët ka blirë të dendur dhe shtylla tipike që ngjasojnë me fenerët e dikurshëm të viteve 800. Në prag të Krishtlindjeve dhe Vitit të Ri, ky bulevard hijesohet nga dritat e zbulurimet e shumta, plot larmi e hijeshi, krejtësisht i veçantë. Ndërsa zbulohet edhe për festën kombëtare, në 14 korrik. Në të dy anët e bulevardit ka dyqane e bare luksoze. Te Harku i Triumfit ka shumë njerëz. Sikurse gjetkë edhe këtu ka plot kuriozë që vijë e bëjnë foto, madje ka edhe nga ata që janë të ngeshëm e ngjiten deri lart në tarracën e tij për të parë Parisin nga ajo pikë, që edhe pse nuk është shumë e lartë, është në një shesh në formë ylli dhe kjo të jep mundësi të magjepsesh me pamjen që të ofron. Harku i Triumfit është 50 metra i lartë. Ndërtimi i tij filloi në vitin 1808 nga Napoleoni që të përjetësonte fitoret e tij. Pallati u inaugurua në 1836. Poshtë tij gjendet edhe varri i ushtarit të panjohur, i vrapë në Luftën e Parë botërore. Ai nuk duket, por janë veteranët ata që sjellin lule përherë, por kësaj here ato nuk bien në sy, ca edhe për faktin se edhe vetë veteranët janë rralluar dhe shumë pak e dinë këtë fakt. Për më tepër në atë mori njerëzish nga vende të ndryshme të botës nuk ke mundësi të dallosh asgjë. Ai mbetet sinonim dhe mishërim i lavdisë.

Duke vijuar më tej, sa në një anë të Senës, në anën tjetër, nga njëra urë në tjetër, gjithnjë duke ecur në këmbë, dukej sikur rruga s'kishte të sosur. Ora kishte kaluar 20.30 minuta dhe dielli ishte ende shumë lart për të perënduar. Një fakt që na çuditi, por edhe na gëzoi sepse kishim ende kohë për të parë qytetin. Më mirë të ecim në këmbë, edhe pse sa vinte e këmbët tona nuk po i ndienim. Kishim bërë mbi 2 orë e gjysmë rrugë dhe ende ishim thuajse në gjysmë të rrugës që kishim planifikuar. Destinacioni ynë i fundit për atë ditë ishte Kulla Eifel, që dukej sikur na e bënte me dorë, por që ende ishte shumë larg.

Si e kapërcëmë disa herë Senën, në qendër, në Parisin e vjetër, syri të zë vetëm ndërtime të vjetra dhe nuk lejohen ndërtime të reja.

Pranë urës së Almës, ndalojmë për t'u çlodhur. Poshtë nesh shkojnë njëra pas tjetrës anijet e tipit "bato mush", të mbushura plot me turistë, të cilët preferojnë të shijojnë Senën dhe Parisin me anë të rrjedhës së lumit, ndërsa të tjerë kanë zgjedhur autobusët e kuq, por ne u besojmë këmbëve tona që dridhen...

Diku më tutje shtrihet Kisha e Invalidëve. Aty prehet edhe Napoleon Bonoparti. Kishim dëshirë ta shihnim por ishte vonë e nuk kishim kohë. Ndoshta do të mbetej për një herë tjetër, ashtu si shumë monumente të tjera.

Kaluam edhe urën e Aleksandrit, një urë e ndëruar në fund të shekullit të XIX, si simbol i miqësisë franko-ruse. Ajo u inaugurua më 14 korrik 1900, me rastin e Ekspozitës Universale.

Afër Kullës Eifel ka edhe një urë tjetër, por ndodhen edhe stacionet e shumta të barkave turistike. Aty rreth orës 21.00 të mbrëmjes gjendem në këmbët e kullës më të famshme, Kullës Eifel. Pranë njërës prej këmbëve të kësaj ndodhet busti i projektuesit e ndërtuesit të saj, Gustav Eiffel. Me qindra turistë gjenden edhe aty. Radha për të marrë bileta e për t'u ngjitur lart është e madhe. Nuk kemi asnjë mundësi përveçse t'i vijmë rrotull e të ndalojmë përballë saj, nga ana e sheshi Trokadero. Atje çifte të tëra, të rinj e mjaft turistë vijojnë pelegrinazhin e tyre dhe fotot simbolike. Nuk ka njeri që nuk ka qenë në Paris e të mos ketë bërë aty një foto. Kulla Eifel, 327 metra e lartë, që prej 8 marsit të këtij viti pasi aty janë instaluar



disa antena të reja që e kanë rritur lartësinë me disa metra. Ndërtimi i saj filloi në 1884, me një sërë polemikash, por që në fund triumfoi si epërsi e teknologjisë franceze dhe u inaugurua në ekspozitën universale në 1889. Ndërtimi i saj zgjati 2 vjet, 2 muaj e pesë ditë ekzaktesisht. Ajo është ndër shtatë objektet më të vizituara të Parisit. Sipas një statistike Kulla Eifel vizitohet thuajse çdo vit nga rreth 7 milionë vizitorë, (me biletë), pa llogaritur të tjerët që shkojnë rreth saj, bëjnë foto e largohen.

Nata bie dhe fillojnë e ndizen dritat në kullën Eifel, vizitorët janë po aq të shumtë sa më parë. Ora ka kaluar 10 e gjysmë dhe duhet të marrim metron për të shkuar në anën tjetër, drejt hotelit, në Montreuli. E nesërja ka të tjera surpriza. Mbi të gjitha na pret seminari dy ditor pranë institutit INA, për të cilin edhe kemi ardhur...

Për të vajtur në Bri sur Marne, ku gjendet instituti Ina duhet të marrësh RER A, një tren shpejtësie që na nxjerr nga Parisi. Si takohemi me z. Michel Dauzats, ai që mundësoi dhe bëri të mundur edhe seminarin tonë shkojmë drejt INA-s. Sa për dijeni Instituti Ina është një institucion shtetëror, i themeluar në 1974, me ligjin e 7 gushtit, me qëllimin e mirë për të ruajtur dhe monitoruar gjithë pasurinë audiovizive të Francës. Ina është një qytet i tërë, dhe që në rrjedhën e viteve ka fituar të tjera përmasa nga ai i krijimit të tij si një institucion industrial e komercial. Sot ai është një institut për ruajtjen e trashëgimisë së televizionit e radios franceze. Ai ka për qëllim ruajtjen, promovimin dhe ekspozimin e arkivit kombëtar audiovizual. Pa hyrë në detaje për këtë institucion, citojmë se vetëm në vitin 1999 ka filluar digitalizimi i gjithë fondit arkival dhe sot arkivon dhe mirëmban 100 kanale televizive, 20 radio. Në atë punojnë mbi 900 vetë dhe çdo vit ky institucion sjell miliona euro fitime nga shitjet televizive. Është institucion tërësisht shtetëror dhe që falë teknologjisë së re, deri në 2015 deklaron se do të mbyllë të gjithë procesin e digjitalizimit të fondit.

Franca është atdheu i filmit dhe kur futesh në këtë institucion, që nuk është më i vjetri, por nga më të rëndësishmit, mbetesh pa fjalë.

Qindra specialistë punojnë nëpër zyra për të shpëtuar atë pasuri të vlefshme të krijuar në dhjetëra vite. Pajisje nga më të fundit, robotizim dhe kërkesa të larta profesionale. Ne kemi ardhur këtu për të përfutur nga përvoja, por sa? Nuk është rasti të bëjmë një analizë të institucionit tonë, por e vetmja gjë që mund të krenohemi ne është thjesht pasuria filmike që kemi në kot 60-70 vjet, pasuria në 35 mm, asgjë më shumë. Na duhen pajisje, na duhen njerëz, para. Mbi të gjitha duhet që dikush të mendojë seriozisht. Ndoshta brezat që vijën mund të bëjnë diçka. Ajo që na mbetet ne është thjesht ruajtja, mirëmbajtja e pelikulës, por edhe ajo ka një kohë fizike skadimi e nuk mund të zgjasë shumë. Prandaj dalin format dhe pajisjet e reja për ta ruajtur, shpëtuar dhe transmetuar këtë trashëgimi të madhe kombëtare brezave që vijnë. Seminari e bëri punën e vet. Ne pamë si bëhet, si ruhet, si restaurohet, si korrigohet e si trashëgohet. Qëllimi nuk është të matemi me ta por thjesht të shikojmë se çfarë mund të bëjmë me ato që kemi. Pa hyrë në detajet e seminarit, mjafton një falënderim për ata që e mundësuan dhe dy ditë ishin shumë për t'u informuar e për t'u trishtuar njëherësh...

Mbrëmjeve kishim kohë që të shijonim bukuritë e Parisit. Në drejtim të sheshit San Mishel gjenden, mes të tjerave edhe dy mrekulli të tjera, Kopshti i Luksemburgut dhe Panteoni. Kopshti është vërtet një mrekulli. Aty dynden parisienë e vizitorë nga e gjithë bota. Ata që kanë më shumë kohë, gjejnë një mundësi për ta parë. Tani është pranverë dhe era e mirë e blireve dhe pemëve të tjera të deh. Kopshti u ndërtua në vitin 1612 me kërkesë të Marie de Medicis. Gjatë perandorisë së parë u bë objekt restaurimi dhe sot ka po atë formë si dikur. Shtrihet në 23 hektarë, i mbushur plot me lule, pemë e statuja, me një shatërvan freskues në mes e burimin e freskët, të zbuluar me statuja. Vetëm 21 ha janë të hapura për publikun. Kopshti është pas Pallatit të Luksemburgut, sot seli e Senatit Francez. Në kopsht ke qejf të rrishe e të çlodhesh. Janë me qindra turistët e parisienë që vizitojnë kopshtin. Rrotull kopshtit, në një prej banesave aty pranë banon sot edhe shkrimtari ynë i shquar Ismail Kadare. Sikurse poetët e mëdhenj francezë edhe ai gjen pak frymëzim tek ai kopsht marramendës.

Ngrihem më pas për të shkuar drejt Panteonit. Panteoni është një monument i stilit neoklasik, i ndërtuar në vitet 1758-1790. Fillimisht shërbeu si kishë, sot, me 83 metra i lartë, në të prehen emrat më të mëdhenj që kanë bërë historinë e Francës. I fundit që u varros aty pas 200 vjetësh, më 2002, është Aleksandër Dyma, i cili u la jashtë sepse ishte mulat!

Natën e presim në një nga brasëritë e lagjes Kartie që gjallërohet nga të rinjtë. Nën shijen e një gote vere përflaket horizonti e nata bie po aq madhështore mbi Parisin që nuk ka gjumë...

Ditën e fundit ia dedikojmë pjesës moderne të Parisit si dhe Sacre Coeur e lagjes Montmartre. Marrim metron drejt stacionit të fundit La Defance. Metroja e Parisit është një

habi më vete. Parisi i ngjan një rrote djathi të shpuar, në të cilën lëvizin si minjtë trenat e njerëzit e shumë që shkojnë sa në një cep në tjetrin, nga ora 5 e deri në orën një pas mesnate trenat nuk pushojnë, në çdo tre katër minuta. Në metro është pastër, ka me qindra reklama e njerëz që nxitojnë. Ka edhe artistë që e ushtrojnë profesionin e tyre aty për të fituar diçka, përveçse ndonjë duartrokitje të rastit. Sikurse ka edhe lypsa e shumë burdonë që flenë e zgjohen në stolat përreth. Ky është Parisi me shkëlqimin, por edhe anën tjetër të medaljes. Zbresim në stacionin e fundit, në këmbë të harkut të madh. La Defance, apo zona e mbrojtjes, lidhet me luftën franko-prusiane të vitit 1870. Këtu parisienët bënë një rezistencë të fortë. Në kujtim të kësaj lufte është ngritur një monument, disa luftëtarë dhe një mortajë mbi të. Deri në vitet 60 –të kjo zonë ishte vërtet periferi, ndërsa më pas u ndërtua një kompleks i madh me kulla të larta moderne. Janë mbi 40 kulla në të cilat punojnë mbi 50 mijë nëpunës. Aty u ndërtua Harku i ri i Triumfit, një hark modern, plot 110 metra i lartë, i quajtur Harku i Madh, i cili u përuar në vitin 1989, me rastin e 200-vjetorit të Revolucionit Francez. Përreth ka mjaft turistë që vizitojnë dyqanet e shumta, skulpturat moderniste kullat e qelqta.

Mua, si shumë të tjerëve, më pëlqejnë fotot dhe nuk le rast apo cep pa bërë një foto. Le të jetë kujtim. Më pas marrim rrugën e kthimit drejt Montmartre. Këmbëjmë metro dhe dalim para Sacre Coeur. Edhe kjo një nga pikat më të vizituara të Parisit. Bazilika e Sacre Coeur u ndërtua mbi majën e një kodre, nga ku Parisi duket thuajse i tëri i shtrirë sa gjatë e gjerë. Ajo u ndërtua në vitet 1875-1919 dhe është nga veprat më të mëdha e më të bukura. Mbi 2 minona pelegrinë e vizitorë që vizitojnë çdo vit këtë monument historik. Rruga që të çon aty është e mbushur plot me njerëz. Ka turistë të shumtë, por ka edhe tregtarë që shfrytëzojnë turizmin për të shitur suvenire, sikurse ka edhe mashtrues e tregtarë suveniresh me ngjyrë që të ngjiten pas e nuk të shqiten deri në bezdisje. Që aty lart Parisi duket bukur, aq më tepër kur edhe dita është e kthjellët, ngrohtë e me diell. Kur viziton këtë monument, përgjatë saj, në Montmartre, nuk le pa kaluar një herë nga Moulin Rouge. Është mesditë dhe në mbrëmje është më mirë të kalosh, por edhe tani jo keq. Rruga përgjatë është e mbushur me dyqane erotike e tek tuk ka edhe klube me striptiza që të ftojnë të futesh brenda. Nuk është rasti, mjafton një buzëqeshje e vidojmë rrugën. Moulin Rouge është i thjeshtë nga jashtë, i veçantë, por emrin e ka të madh. Aty ka spektakle marramendëse të cilat mund t'i shijosh me një vlerë prej 130 eurosh. Aty ka muzikë, shampanjë e spektakël balerinash që fluturojnë si petale e që të lënë pa frymë.

Paris është i madh e i bukur gjithandej. Çdo cep rruge është një monument, një histori, një bukuri. Bastija, Opera, galeria La Fayette, kulla e Monparnasit, Versaja, Disleiland e shumë të tjera, janë bukur që duhen eksploruar me nge e duhen ditë të tëra për t'i parë e përshkruar. Ditët e orët nuk mjaftojnë. Thjesht sa për të kujtuar se në Paris 10 janë gjërat më atraktive turistike, më të frekuentuara, sipas një burimi të viteve të fundit:

Në vend të parë qëndron Katëdralla "Notre-Dame de Paris" me 12 800 000 vizitorë, në vend të dytë "Disneyland Paris", me 12 400 000, i treti Bazilika "Sacré-Cœur de Montmartre" me 8 000 000, i katërti Muzeu i Luvrit me 6 600 398, në vend të pestë Kulla Eifel me 6 229 993, i gjashti Qendra "Georges-Pompidou" me 415 368 548, i shtati Kështjella e Versajës me 3 300 200, kjo për faktin se është larg Parisit, në vend të tetë Qyteti i Shkencës dhe Industrie në Parkun Villette, me 42 2 795 000, i nënti Muzeu "Orsay" me 2 590 316 dhe në vend të dhjetë Muzeu Kombëtar i Historisë Natyrale, me 43 1 444 744 vizitorë në vit. Këto janë të dhëna nga entet e turizmit francez, por Parisi është magjik në 360 gradët e tij.

Të vjen keq të largohesh nga ky qytet i madh e i bukur, "kryeqyteti i botës", por që duhet bërë. Në orën 19.00 na pret avioni i linjës "Lufthansa" në aeroportin "Sharl de Gol". Marrim taksinë drejt aeroportin, por kokën e kthejmë pas, duke menduar... "A bientôt!"

Sakrilegj në Shën Naum

Një arkiv i madh që mbledhur në manastirin e Shën Naumit nga e gjithë dioqeza e gjerë e Tij. Vendosur me kujdes nëpër rafte, arka, sëndyqe varg. Gjetjet arkeologjike rrëzë mureve gjithandej. Gjithë ajo pasuri ishte histori e dituri, ishte jeta e shekujve të shkruar pranë liqenit të Liknidës. Por erdhi viti 1850 dhe...

Nga Kristaq NANUSHI

Murgu Serafim vinte vërdallë nëpër manastir. Një siklet i madh e përcëllonte gjer në palcë. Si asnjëherë tjetër. Si askund tjetër në murgjëri. Për të tretën herë i vinte urdhër nga Stambolli që... të digjte arkivin e Shën Naumit. "Po ky është sakrilegj, mendonte, pse ta djeg?". Shkonte nga konakët dhe thoshte: "A digjet një arkiv?". Kthehej pas kishës dhe psherëntinte: "Pse digjet një arkiv?". Dilte te shkëmbi-balkon mbi liqen, humbte shikimin në hapësirën e kaltër dhe psherëntinte: "A digjet një histori?".

Vendi s'e mbante. Kaloi nga bodrumi, nga qilarët, u kthye nga gjellëtorja, nga dhoma e gjatë e ngrënies, nga furra e bukëve, kapërceu stivat e druve, doli matanë, te spitali, përshkoi çardhakun dhe u afrua te dhoma e arkivit. Dhjaku e shikonte me gjysmën e fytyrës, nxjerrë pas një kapitoli mermeri.

Murgu Serafim hyri në arkiv dhe kontrollloi me sy gjithçka. Vend të madh zinte biblioteka me kodikë e libra shumë për jetën e qiellit dhe jetën e tokës, regjistra për familjet dhe pronat e tyre, regjistra për pagëzimet, defterë për taksat dhe prodhimet bujqësore e blegtorale, blloqe të zverdhura shënimesh, zarfe të dyllësura e letra me fjongo, pako me dorëshkrime e dokumente të qeverive, të lidhura me pe liri e pe leshi... Kishte ikona e piktura të vjetra, gravura në gur e bakër, koka njerëzish të shquar, të gdhendura në gur e dru, vizatime me figura të çuditshme, mistike dhe realiste. Kishte, gjithashtu, harta, flamuj, stema, vula, unaza, monedha të vjetra, sende bronxi, ari e argjendi, të lashta e të reja, me emra, figurina e simbole të llojllojshme...

U ul te pragu i derës dhe arsyetoi: "Po bëhen një mijë vjet, që kur shenjtja Naum erdhi në këtë Kishë të Kryeengjëljeve dhe jetoi e punoi shenjtërisht. Ka një mijë vjet pas vdekjes, që përhap bekim e paqe, prehje e mirësi. Ka shëruar dhe ka lehtësuar plagë

të trupit e plagë të shpirtit. I ka mbajtur në vëllazërim njerëzit e viseve afër e larg edhe pasi qeni turk i ktheu një pjesë në myslimanë. I bashkon në vlerat morale e njerëzore. I mban në fqinjësi të mirë edhe me kombet e tjera. Sepse Zoti një është, e kemi dhe e duam të gjithë. Ky manastir u ruan njerëzve edhe këtë pasuri të madhe të tyre, historinë e jetës që para Krishtit. Ç'të keqe u ka bërë atyre, atje, në Stamboll?".

Ngriti sytë mbi kubënë më të lartë të kishës, te kryqi, dhe ndjeu nga brenda një avullimë. "Jo, jo, tha duke bërë kryq, ky është sakrilegj! Arkivin nuk do ta djeg!".

Doli më nxitim jashtë mureve të manastirit, nëpër pyllin me lisa shekullorë. Ndjeu nevojën të ecte. Dhe eci, eci...

U ul mbi burimet ujëshumta të Drinit, që krijonin mes pyllit një liqen të kthjellët. Liqeni nuk kaltëronte prej qiellit, po gjelbëronte prej pyllit. Ish-te aty si një copë parajsë, e nxjerrë nga përrallat. Gjithandej notonin shpendë e këndonin zogj. Nëpër ujë zbardhnin zambakë me pistile të verdha, mjellma me sqepa të verdhë dhe nositë me gusha të verdha. Kishte dhe plot lule të vogla, sidomos të kaltra. Mes kallmit të çelur gëlonin shpendët që bënë dashuri, ndërtonin çerdhe e çelnin zogj. Patat dhe rosat e egra i përziennin kolonitë e tyre, kurse mjellmat e përrallta rrinin veçan, ca në ujë e ca në breg, duke u shpendluar. Në breg, mënjanë, një çift nositësh nuk ndahej nga foleja me vezë, nën fier. Një dritë e bardhë dhe një tis i paqtë binte. "Këtu vetëm engjëj ka, tha Serafimi, ç'të keqe shohin ata atje, në Stamboll?".

Pastaj eci përgjatë lumit të shkurtër që ujërat e Drinit i nxirrte me vrull e shkumbë në liqenin e madh, nëpër të, në Strugë. Nëpër vrull të ujit nuk kishte shpendë. "Nuk duan dallgë e zhurmë, mendoi. Nga liria e botës së madhe u mjafton ky pak vend mes pyllit, me ujëra e lule e zogj. Nga zhurmërima e botës së madhe duan vetëm gurgullima, cicërima dhe tinguj të kabanës së kishës pranë. Në këtë limoni



"Sakrilegj në Shën Naum", ilustrimi nga Anastas Kostandini (Piktor i merituar)

paqësore kisha bën jetën e saj, por nuk e lënë të qetë. Vjen që larg një qoftëlarg dhe...".

Eci buzë liqenit të madh dhe u ndal tek hambarët e manastirit, poshtë kodrinës. "Këtu, vazhdoi me vete, më shumë sesa njerëz për halle dhe për ndjesë, udhëtarë të varfër dhe të pasur, endacakë të lodhur dhe të sëmurë, kanë ngrënë dhe kanë marrë koshadhet e turkut. Për taksat e Stambollit dhe për qejfet e tyre. Tani, në ujdi më Patrikanën, duan të na djegin fare. Tamam punë të Satanait, ptu, ptu!".

U ul mbi guriçkën e pastër të zallit dhe treti sytë mbi liqen. Shikonte lodrat e dritës mbi ngjyrat e liqenit. Për çudi, ngjyrat e bukura u shprishën, u bënë njolla të errëta që u rritën dhe zunë të kërcenin, ndërtonin formë, bëheshin zogj të zinj, kafshë të pakuptueshme, zgjateshin si gjarpërinj, zmadhoheshin, ckërmiteshin, nxirrnin dhëmbë, nxirrnin kthetra...

"Qoftëlargu, tha Serafimi, më ka zënë qoftëlargu!".

U ngrit dhe iku i trembur. U fut në pyll. U ul pas një trunngu lisi. Por trunget përpara hapën zgërbonja. Prej tyre dolën përsëri kafshë të zeza, të çuditshme, të pakuptueshme, që shformoheshin dhe formoheshin ndryshe. Të gjitha njëherësh cijatnin, zgërdheshin, këlthisnin... "Qoftëlargu dhe këtu!".

Ku të shkonte? Mbylli sytë,

që të mos shikonte gjë. Mirëpo i shikonte mendja. Ja, mendja i solli në sy një shishkë që pikonte helm, pastaj një teh të shndritshëm thike, pastaj një grykë dyfeku që nxori dritë e tym, pastaj një litar që u lidh në lak, pastaj një hon me jehonë, pastaj...

Kambana e drekës e solli në vete. U ngrit dhe me kokën që i buçiste e me një cipë djersë hyri në manastir.

Në hajat të dhomës së ngrënies e priste për drekë dhjaku. Serafimi hyri dhe, duke shikuar pjatat, deshi të ulej në tryezë. Po s'u ul. Avujt nga pjatat ngriheshin në forma të çuditshme: zgjateshin lart, ktheheshin anash, përdridheshin, shkurtoheshin, lëpinin njëra-tjetrën, kafshonin njëra-tjetrën... "Lozin valle lugatët", mendoi. Pështyu pas supit të majtë dhe bëri kryq.

-Çfarë ke, hirësi? - pyeti dhjaku.

-Nuk më hahet, më bëj më mirë një kafe!

Dhe shkoi u ul mbi një trunngu lisi, në fund të konakëve, ku ishte arkivi. U përumb në mendime.

-Hirësi! - i foli dhjaku me habi e me kafen zgjatur.

Serafimi u përmend. Mori filxhanin, e afroi, por...avulli iu bë si gjarpër që zgjatej ta kafshonte në buzë. U ngrit, ia lëshoi filxhanin në duar dhjakut të hutuar dhe hyri me vrull në arkiv. Doli me një krah librash dhe i hodhi mbi kall-

drëm, në mes të oborrit. Hyri dhe doli me një krah tjetër librash, që i hodhi mbi të parët.

-Eja, më ndihmo! - i tha dhjakut të ngrirë.

Dhjaku mori të fliste, por hirësia s'e la.

-Pa fjalë! Bëj ç'të thonë!

Dhjaku i shkoi pas dhe, të dy, hyr e dil e hyr e dil nxorën në oborr bibliotekën, regjistrat, defterët, blloqet, fermanët, pakot me dorëshkrime, dokumentat e kishës, të qeverive, ikona, piktura, skulptura në dru, lëkurë me vizatime e mbishkrime të lashta, coha të qëndisura, harta, flamuj, stema, vula... Një pjesë të hedhura, një pjesë në arka e sëndyqe, siç qenë.

U bë një piring i madh.

Të dërrmuar, tërë djersë e pluhur, murg e dhjak u ulën përballë. Dhjaku nuk fliste, por shikonte me sy të zgurdulluar.

-Tani ik! Më mirë ik!

-Hirësi...

-Të thashë ik! Unë kam brenda Satanain. Le ta mbaj për vete. Ti nuk ke faj, mos hyr në ngasje, ik!

Dhjaku u largua i lahtaruar. Murgu Serafim u ngrit, ndezi ngadalë një letër dhe mbajti sytë mbi flakë. Dora i dridhej. Pastaj dora iu dogj dhe letra e ndezur ra...

Serafimi nuk donte t'i shihte ato flakë. Doli nga porta e madhe.

Hyri nga porta e madhe kur agu i mëngjesit kishte ngjyer në portokalli qiellin mbi Mal të Thatë. Në mes të oborrit pa... një piring me hi... një histori bërë hi...

Doli te shkëmbi-balkon mbi liqen dhe priti sa bukuritë e mëngjesit u hapën plotësisht. Dielli doli dhe dritën e parë e pikoi mbi nositët e bardhë. Murgu Serafim ngriti sytë mbi Mal të Thatë, sikur donte të futte diell në kokë të tij dhe tha:

-O Perëndi, të gjithë jemi nga pak Judë, kur prishim ato që themi se i duam! Iu dorëzo-va djallit. Falmë, të lutem!

Pastaj hyri në kishë, ndezi llambadhen e Shën Marisë dhe ra në gjunjë.

-Ç'që kjo nëmë, moj Nënë!

Ndenji një kohë aty, duke u lutur për ndjesë.

Pastaj hyri te kupola me varrin e Shën Naumit. Ndezi dhe llambadhen e Tij dhe ra në gjunjë. Aty ndenji gjatë.

Se ç'foli e se ç'kërkoj ai e diti. Ne dimë që, më pas, ai la një letër me ndjesë e pendesë të thellë.*

*Letrën e ka botuar Zhan Klod Faveiral, në librin e tij "Historia (e vjetër) e Shqipërisë", bot. "Plejad", Tiranë 2004, f. 335. Po aty flitet dhe për djegjen e arkivit të Shën Naumit.

Ritet zakonore në zonën e Mokrës

RITE QË ZBTOHEN NGA LINDJA E FËMIJËS DERI NË MOSHËN KUR KALON FAZA E BEQARISË

Nga Zabit CUKU
Bashkim KRASTA

TË PËRGJITHËSHME

Jeta njerzore kalon tre faza kryesore, lindja, martesja dhe vdekja.

Për dy të parat kemi mundësi të marrim msa dhe të bëjmë pak apo shumë përgatitje, kjo në vartësi të zakoneve, të traditës apo të mundësisë ekonomike. Ndërsa për të tretën (vdekja), kjo vjen papritur dhe nuk kemi mundësi të marrim masa apo të bëjmë qoftë edhe një përgatitje.

Këto faza i kam ndjekur rast pas rasti ndër kohra me takime, biseda të ndryshme, studimin, Bazat e etnologjisë nga Ajet Shahu.. Tiranë. 2009. Njohuri të gjëra më dha intervista me mikun tim Bashkim Krasta nga thellësitë e Mokrës, dhe kështu menduam të shkruajm ashtu siç e njohim qofshin edhe jo të sakta e jo të plota për atë më të rëndësishmen, nga lindja e fëmijës, deri në një moshë të caktuar. Kjo kohë ka patur dhe ka zakone, tradita e doke të rëndësishme edhe emocionuese në jetën njerëzore.

Lidhja në martesë është një moment tjetër i rëndësishëm pasi kjo krijon dhe e forcon më shumë lidhjen midis jetës së çiftit.

Ritet dhe zakonet që shoqërojnë periudhën që nga ngjizja e fëmijës e deri sa të mbushë 1 vjeç, kanë shumë vlera të çmuara, këto mendoj se duhet të ruhen brez pas brezi, të trashëgohen dhe mundësisht të zhvillohen edhe më tej.

Ky shkrim mendoj se duhet të lexohet, të kujtohet nga të vjetrit, dhe të një-

Të jetojmë me fëmijët tanë, duke pasur parasysh gjashtë fjalët magjike: Kënaqsi-Dashuri-Siguri-Pavarsi-Krenari e Shpresë.

(Danielle LAPORTE)



het nga publiku si zakone të traditës Mokrare e më tej. Mendoj se jo çdo zakon i vjetër duhet fshihet nga kultura e një populli, ca më keq të mos zbatohet, kur ka vlera dhe emocione. Tek e vjetra edhe tek e reja ka anë pozitive po edhe negative, sejcili ti vlerosojë sipas rastit.

Të drejtën zakonore që ushtrohen lidhur me momentet e lindjes së fëmijës si element trashëgimije gjenetike në familjet e çdo kombi përbën një moment të rëndësishëm. Cermonitë janë nga më të ndryshmet për popujt dhe këto ndryshojnë nga një krahinë në tjetër. Këto ndryshojnë për djalin dhe për vajzën e lindur.

Shumë zakone dhe rite fetare të ruaj-

tura gjatë shekujve nga popuj të ndryshëm janë me të vërtetë një pasuri kulturore e domosdoshme të cilat kanë vlerat dhe dobitë e veta sado që të modernizohet shoqëria dhe të përparojë teknologjia. Por ka edhe disa zakone në të cilat nuk vërehet asnjë dobi por populli i ruan thjesht për faktin se kështu i kanë parë të parët e tyre duke vepruar.

Në vijim do të rendisja disa prej riteve, zakoneve që zbatohen dhe shoqërojnë lindjen e fëmijës. Aty qartë vërehen ato rite që janë të nevojshme dhe ato që janë edhe të pavlera.

II LINDJA E FËMIJËS

Ardhja në jetë e një fëmije është ngjarje me rëndësi në jetën e familjes. Lindjen e shoqërojnë shumë doke e rite me prejardhje nga shtesa të ndryshme historike-kulturore. Duke filluar nga paganizmi e deri te fetë monoteiste. Zakonet dhe ritet e shoqërojnë gjithë procesin e lindjes së fëmijës. Mentaliteti popullor shqiptar parapëlqen lindjen e djemve dhe nuk ndien të njëjtin gëzim për lindjen e vajzave, kurse sipas fesë Islame nuk ka dallime mes djemve dhe vajzave pasi të dy i jep Zoti. Zoti i qorton në Kuran ata që mërziën për lindjen e vajzave. Dëshira e familjes për fëmijë, sidomos për djem buron nga dëshira për ripërtitjen e jetës.

Në përzgjedhjen e nuses preferohet

që nusja të rrjedhë nga një derë e mirë ku kishin lindur shumë djem. Dëshira për fëmijë shprehet në urimet që shprehen për çiftin e ri, si: “u trashëgofoshi e u sh-tofshi”, “të gëzoheni me një turmë djem”, “të bëni një djalë se duhet ushtarë”, “të na gëzoheni me shumë djem”,.....

Martesa quhej e kurorizuar kur nusja mbetej shtatëzënë. Kjo përbente një ngjarje me rëndësi në familje. Shtatëzania e ngarkonte nënën si me faj prandaj ajo përpiquej që ta maskonte rritjen e barkut dhe shpesh qëndronte kokulur.

Në përgjithësi për gruan shtatëzënë tregohet një kujdes i veçantë në ushqim dhe në jetën e përditshme. Vjehrrat zagonishtë përgatitën ushqime më të mira për nusen kur është me barrë. Mençuria popullore e ka përligjur këtë nevojë njerëzore. Në këtë drejtim përveç kujdesjes për nënën e re ka pasur edhe qëndrime diskriminuuese.

Është parë se në disa krahina gruaja me barrë ka bërë edhe shumë punë të rënda. Ajo ngarkonte dru, dilte në arë për të punuar e korrur, dhe u shërbente të gjithë pjestarëve të familjes. Nusja e vogël duhej të punonte më shumë se të tjerat e pa bërë zë. Steriliteti i gruas shkakton shumë probleme në mentalitetin popullor. Për të ndjellë pjellshmërinë e gruas kryhen disa rituale magjike. Shumë praktika rituale i zbaton jo vetëm gruaja por edhe burri.

Lindja përbën pikën kulmore të pritjes së gjatë familjare. Akti final i lindjes është i mbushur me veprime magjike të shumta. Ato synojnë të mënjanojnë rreziqet dhe të sigurojnë një fat të mbarë për fëmijën. (vijon ne faqen 8)

E rrallë, majori amerikan Harold Spicer, luftoi për mbrojtjen e Pogradecit

Prof. Dr. Uran ASLLANI

Në janar shkurt të vitit 1914, u dërgua në Shqipëri, Majori Harold Sherwood Spencerin, për të vrojtuar dhe ndjekur ngjarjet e asaj periudhe, kur në Shqipëri do të vednosej PricW. Wieddi. Rrethet atdhetare të migracionit në SHBA u informuan dhe e vlerësuan saktë e drejtë Harold Sherwood Spencerin, qysh në fillimin e veprimtarisë së tij në Shqipëri.

Me ardhjen e princ Wied-it si mbret i Shqipërisë, Harold Sherwood Spenceri, ashtu sikurse kapiteni irlandez Armstrong, hyri në shtet në xhandarmërisë shqiptare ose si shkruan Edwin Jacques, në stafin e princit. Në radhët e asaj xhandarmërie njihej si “major” Spneceri.

Armstrongu në librin e tij “Gjashtëmuaj mbretëri në Shqipëri” për Spencerin shkruan si vijon: “Së bashku me xhandarmërinë e komanduar me kapitenët Gani Butka, Leon De Ghillardi, nga majorët holandezë Ruller, Snellen e Vallenhofen, kapitenët Mallinkcerft, Durman dhe majori Spencer mori pjesë aktive në çlirimin e Korçës nga ushtria greke. Madje e ai u bë nismëtra i rrethimit të mitropolisë, kapjes dhe burgosjes të peshkopit grek Jakovit, me një veprimtari të vazhdueshme antishqiptare edhe dërgimit të tij në burgun e Elbasanit. Edwin Jacques shënon se Spenceri luftoi kundra grekëve së bashku me xhandarmërinë e vullnetarët shqiptarë edhe në Luftën e Qinanimit, 3 milje larg Ersekës. Më pas së bashku me Gani Butkën dhe të tjerë vullnetarë, më 2 maj 1914, luftoi kundra rebelve antishqiptarët Haxhi Qamilit dhe bashibozukëve turkoshakë të Esat Bej Starovës, tek Guri i Prerë, në zonën e Pogradecit.

Në këtë betejë me forcat të pabarabarta, ku forcat rebele turkoshake ishin disa mijra,



humbën jetën disa dhjetra xhanadrë dhe vullnetarë dhe midis tyre kapiten Gani Butka, Zalo Prodan etj.

Sipas gazetës “Dielli” datë 3.8.1914 mbas betejës xhandarët me në krye kapiten Ghillardin dhe major Spencerin u kthyen në Korçë por atje nuk qëndruan gjatë. Ata së bashku me shumë atdhetarë të tjerë korçarë, midis të cilëve Mihal Grameno Themistokli Gëmenji, Qani Dishnica etj. Më 23 qershor 1914 u larguan nga Korça në drejtim të Voskopojës. Një ditë më pas më 24, nëpër Opar u nisën në drejtim të Beratit.

Ndërkohë, gazetari i thotë amerikanit se Gani Butka nuk ishte gjeneral, por Spenceri i përgjigjet menjehere: “Unë si oficer me pervojë kuptova menjehere se i ndjeri Gani Butka ishte gjeneral praktik i mbaruar. Kish-te edhe të tjerë luftëtarë kapedanë Kajo e Sali Butka, po trimëria, guximi dhe patriotizmi i gjeneral Gani Butkës më bëjnë të mos e harroj kurrë. Gani Butka ishte bërë vëllamë me mua d.m.th. kishim pirë gjakun e njëri tjetrit, sipas zakonit shqiptar.

E shikon këtë unazë me shkabën në mes të saj që unë mbaj në gisht? Këtë unazë e kam dhuratë nga Ganiu, është shenjë vëllazërie dhe unë s’do ta heq kurrë nga gishti

deri sat ë vdes. I ndjeri Gani s’ndahej prej meje, por edhe unë vetëm tek ai kisha besim. Po fati i keq i shqiptarëve se përveç grekëve u ngritën kundra nesh myslimanët fanatikë.

Në atë kohë morëm urdhër që të niseshim nga korça për në Pogradec kundra kryengritësve. Këtu gjeneral Ganiu tregoi trimëri të madhe dhe kryengritësit i ndoqëm si galat. Po e them bej Starova vajti në çdo fshat të Gorës, duke u thënë njerëzëve të pamësuar të ngriheshin kundra qeverisë dhe se xhandarët kishin shkuar gjoja për të ndërruar fenë. Kësisoj fshatarët u ngritën me shumicë të madhe dhe na rrethuan ligisht. Bëmë luftë të përgjakshme, por u mundëm. Disa prej nesh shpëtuan ndërsa të tjerët u vranë. Heroizmi i gjeneral Butkës në atë luftë nuk mund të tregohet as me gojë dhe as me pendë. Kryengritësit i kërkuan të dorëzohej, por vëllai im u tha: “S’bëhem teslim tek ju tradhëtarë” dhe pasi vrau disa prej tyre me revolverin e tij, plumbin e fundit ia lëshoi vetes dhe vdiq duke qeshur me flamurin e Shqipërisë në dorë. Gani Butka ishte, petrit, ishte trim i trimave”

Sërish gazetari e pyeti amerikanin Spencer: “Po ju z. Spencer si oficer i rregullt që ishit, a morët rrogë nga qeveria shqiptare?”

Harold Sherwood Spencerin i përgjigjet në këtë mënyrë: “Jo nuk mora asnjë dyshkë. Ishte turp të kërkova rrogë nga Madhëria e Tij, i cili harxhonte të hollat e tij për të qeverisur shqiptarët. Asokohe unë isha komandant i gardës së pallatit, të cilët numëroheshin rreth 500 shpirt.

Majori Spencer mbasi e kreu detyrën e rëndësishme, arriti në Boston dhe në radhë të parë vizitoi selinë e “Vatres” si dhe zyrat e redaksisë “Diellit”. Ai u gëzua dhe uroi atdhetarët për makineritë e reja të shtypshkrimeve dhe zyrat funksionale. Ai pëlqeu edhe tematikën e artikujve të botuar, duke

u thënë atyre: “You are doing a great work for Albania”.

Gjatë bashkëbisedimeve me atdhetarët e “Vatres” Spenserit me pervojë politike i informoi ata se Italia do të merrte pjesë edhe ajo në luftë dhe se do të pushtonte Shqipërinë me argumentin e luftimeve me ushtrinë austro-hungareze, më anë tjetër ai shkroi edhe artikuj për demaskimin e politikës shoviniste greke edhe në SHBA.

Pikërisht në këtë kohë, në gazetën “Dielli”, nën sugjerimin e Spencerit, botohet një artikull për detyrat e emigracionit dhe federatës “Vatra”, midis të tjerëve shkruaj kësh-tu; ...Midis problemeve dhe detyrave të ndryshme që kemi, është edhe krijimi i një komisioni që do të përfqësonte atëdheun nëpër konferencat e ndryshme ndërkom-bërëtare për paqen që do të zhvilloheshin në Evropë ose edhe në Uashington Në të këtij komisioni të caktohej një nga filoshqiptarët e nderuar amerikanë. Nga mbi 40000 shqiptarë që jetojnë dhe punojnë në SHBA mund dhe të nxiret një bërthamë djemsh për të organizuar këtu në SHBA xhandarmërinë shqiptare. Nga kjo bërthamë të formohet një trup i shenjtë nën emrin “Legjioni Shkabës” nën komandën e majorit H.Sh. Spencer, amerikanit filoshqiptar që luftoi bashkë me shqiptarët kundra grekëve dhe osmanllinjëve. Ky trup kur të vejë në Shqipëri të vihet nën komandën e xhandarmërisë shqiptare”. Kjo dëshirë e objektiv i atdhetarëve të SHBA nuk u realizua, si gjithmonë nga ndryshimet e mendimeve të kontributeve financiare të pa mjaftueshme. Ndaj Harold Sherwood Spenceri u kthye në Evropë dhe në mesin e vitit 1915, u fut sërish në shtet nën sekret të ushtrisë britanike, me gradën kapiten. Në vitin 1917 Spenceri sëmuret nga një krizë e sitemit nervor, largohet nga lufta dhe del në invaliditet, Nuk disponojmë të dhëna se kur dhe ku ka vdekur.

JETA NË BURG E SHKRIMTARIT MITRUSH KUTELI

“Në kampin e Vloçishtit, Kutelin e varrosën të gjallë”

Dëshmia tronditëse e Efterpi Paskos përmbyll rrëfimin e të shoqes së poetit të persekutuar. Nga kujtimet e 88-vjeçares që ka ndarë për 20 vjet gëzimet dhe hallet me Kutelin.

E shoqja e shkrimtarit të madh Mitrush Kuteli bën një rrëfim tronditës në një intervistë në gazetën “Panorama”, që janë mjaft tronditëse. Një javë pasi doli nga burgu e deri në gusht shkuam në Pogradec. Në Tiranë nuk kishim shtëpi, pasi “na kishin dalë urbanizimi”. Gjatë kësaj periudhe, Dhimitri, kohën më të madhe e kalonte me përkthime, të cilat ia dërgonin nga “Zëri i Popullit”, por edhe me krijime të tijat. Në gusht të vitit ‘49 e emëruan te “Zëri i Popullit”, në sektorin e përkthimeve. Tanimë që u rregullua me punë, problem mbetej strehimi. Për disa kohë qëndruam te një i afërmi ynë. Më pas, kur na lindi vajza, shkuam në hotel...

Në atë kohë e morën sepse kishin nevojë të ngutshme. Kur gjetën një tjetër siç iu përshtatej, e hoqën menjëherë. Sa punoi te “Zëri i Popullit”, në përgjithësi kaloi mirë. Megjithatë, fakti që kishte qenë dënuar për agjitacion e propagandë, nuk e la pa telashe. Çdo komunikim, çdo sjellje e tij shikohej me kujdes të madh. Patjetër në emër të parimeve. I vënë në këtë vëzhgim, nuk do t’u shpëtonte kritikave e bile edhe goditjeve...

Raste ka pasur disa, por tani pas kaq vitesh, nuk më kujtohen të gjitha. Mbjaj mënd rastin kur e nxorën në gazetën e murit në formë karikature me diçiturën “Amerikaniada e shokut Pasko”. Me anë të saj mundoheshin ta godisnin si intelektual borgjez...

Në atë periudhë nuk kishin dalë fletë-rrufetë. Në vende pub-



E MADHE ËSHTË GJËMA E MËKATIT", MONODRAMA E KUTELIT NË KSAMIL

Monodrama e Mitrush Kutelit “E madhe është gjëma e mëkatit”, u shfaq për herë të parë mbrëmjen e djeshme në qendrën kulturore “Dea” në qytezën e Ksamilit, në jug të vendit. Një interpretim virtuoz i aktorit korçar, Ligoraq Riza i ka bërë artdashësit t’a përjetojnë me emocion të veçantë këtë pjesë, e cila përcjell mesazhin e dënimit të mëkateve nga Zoti me dënimin më të rëndë: atë të pavdekësisë. Monodrama trajton jetën dhe dashurinë e Tan Tanushit, e cila fillon në kohët e Ilirisë. Limoz Dizdari, administratori i qendrës kulturore “Dea”, tha se, “ky aktivitet kulturor do të pasohet nga të tjerë gjatë javëve të ardhshme, duke ofruar bashkë me sezonin veror, edhe jetën artistike në qytezën e dhjetëmijë banorëve, që trefishon vetveten në çdo tur pushimesh”.



like e në qendra pune kishte gazeta muri, ku goditeshin sjelljet e shfaqjet e papërshtatshme me kohën, me frymën e saj. Kjo fushatë me karikatura e bejte të ndryshme, drejtohej nga lartë e shitej si zëri i masës...Gjatë punës në redaksi, një moment Dhimitri kishte vënë këmbët mbi një karrige aty pranë. Që nga koha e burgut ai kishte probleme me gjymtyrët dhe vuante nga dhimbjet e reumatizmës. Dikush e kishte parë dhe i ishte kundërvënë menjëherë. Një qëndrim i tillë, sipas tij, nuk mund t’i falej askujt, dhe jo më Dhimitrit që ishte dënuar për agjitacion e propagandë. Kjo ishte e mjaftueshme që “redaksia” e gazetës së murit, brenda redaksisë së “Zërit të Popullit”, ta vinte në ballë të kritikave dhe goditjes. Këtë here me diçiturën e padëgjuar më parë, “Amerikaniada e shokut Pasko”...

Te “Zëri i Popullit” punoi gati dy vjet. Në vitin 1953 e transferuan në shtëpinë botuese “Naim Frashëri”, gjithnjë si përkthyes, por jo si nëpunës në bordero. Aty paguhej me normë sipas sasisë së faqeve të përkthyer. Ishte kjo një rraskapitje e tmerrshme. Punonte gjithë ditën e gjithë natën për t’i dorëzuar materialet sipas afateve. Nuk më kujtohet me saktësi sa lekë e vlerësonin për faqe, por di të them që këtë mënyrë vlerësimi, Dhimitri e quante qesharake. Kjo mbetej e vanteja mënyrë jetese. Pikërisht në këtë periudhë ka përkthyer nga disa gjuhë mjaft nga kryeveprat e kohës. Të gjitha pa emrin e tij, sepse vazhdonte të ishte “i padëshirueshëm”...Sa ishte në

burg, por edhe disa vite më pas, as që bëhej fjalë për t’i dhënë të drejtë botimi. Pasi doli nga burgu, i dërguan një letër nga Lidhja e Shkrimtarëve, ku e njoftonin se nuk ishte anëtar i saj. Pra, duhej të vazhdonte me normën e përkthimit. Të drejtën për t’u bërë anëtar i Lidhjes ia dhanë shumë kohë më vonë, falë ndihmës së Drago Siliqit që bëri ç’ishte e mundur për t’i kthyer të drejtën e botimit. Në verën e vitit ‘66 më në fund i dhanë një leje krijimi njëvjeçare. U gëzua jashtë mase e shpresoi mjaft për t’u dhënë jetë subjekteve të ndryshme, por nuk zgjati shumë. Në fillimin e ‘67-s, kur kishte nisur fushata e letrës së hapur për “thelimin e frymës revolucionare”, Lidhja e Shkrimtarëve e pa të udhës t’ia ndërprerë lejen e krijimtarisë. Në dëshpërim e sipër, Dhimitri la në mes veprat e nisura dhe rifilloi punën e përkthimit e normuara...E tërë periudha pas burgut ishte e vështirë dhe plot ankth. Ca më tepër kur lindën fëmijët, Polikseni, Atalanta, Pandeliu dhe Doruntina. Megjithatë, Dhimitri, falë kurajës, gjente forca për ta përballuar. Ndodhi një periudhë që e renditën krahas Konicës, Fish-tës e Koliqit, si poetë të padëshiruar. Bilebile, kjo përmendej si vjershë kudo, sidomos midis krijuesve. Ç’bëhet kështu, i thashë një ditë e frikësuar. Nuk e shikon, ma ktheu ai me buzën në gaz, po më nderojnë shumë dhe duhet t’i falënderoj...Pak a shumë kështu ka ndodhur.

Ritet zakonore në zonën e Mokrës

(vijon nga faqja 7)

Organizohen cermoni ku marrin pjesë nga fisi i te dy bashkëshorteve, theren kurbanë dhe pihet raki e deri qëllohet me pushkë, ndizen zjarre.

Fëmija mbahet për 40 ditë larg njerëzve. Kjo se nga syri i keq mund të sjellë një dëm të madh fëmijës e gruas. Për gruan tregohet kujdes për të lehtësuar dhimbjet e lindjes. Pranë saj qëndronte një e afërme e shtëpisë. Asistenti kishte status specializimi për pritjen e të voglit.

Të voglin e lanin me ujë të ngrohtë. Në disa zona uji përzihej me kripë, sheqer, me barëra dhe lule të njoma sipas periudhave kohore. Për gruan lehonë përgatitej një vend pranë zjarrit. Vendi i saj shtrohej me kashtë gruri ose meli. Besohej se gruri, meli, misri, si bimë të mbara do ti jepnin forcë nuses së re dhe do ta mbronin “kërthin e porsalindur”.

Në këtë vend lehonë qëndronte 3 deri 7 ditë. Më pas kashta hidhej sa më larg shtëpisë. Në vend të saj përdorej një dyshek i rehatshëm ku qëndron 40 ditë. Këto quheshin ditët e lehonisë. Koncepti popullor e konsideronte lehonën të papastër. Këto 40 ditë ishin të mbushura me rite magjike për mbrojtjen nga forcat keqbërëse.

Që fëmijës ti garantohej jetë e shëndetshme dhe e gjatë, bëhej kujdes për ushqimin e tij me qumësht nëne. Qumështi i lehonës është i shenjtëruar.

Ekziston një frikë e përhershme mbi mundësinë e largimit të qumështit. Në disa krahina, gruaja me probleme qumështi, shkonte në krua ose te çezma e fshatit, e mbante në dorë bukë e djathë dhe një degë të njomë fiku, ose qumushitore, (bimë që nxjerr lëng të bardhë si qumështi), që të mos e zinte syri i keq. Fëmija vendoset në djep e pas pak ditësh i vendoset emri.

-Lajmi i lindjes së fëmijës, mbahet disi i fshehtë në dy-tre, ditë pas lindjes, përjashtuar njerzit e afërt

-Ditën që lindë fëmija djalë apo vajzë, sidomos për fëmijën e parë, mbidhen familjarët të afërt nga të dy palët e çiftit, dhe të tjerë nga fisi.

-Pas lindjes hapet lajmi me gëzim, për të afërt jepet edhe myzhdeja, një dhurate simbolike e vogël ose monedha lekë sipas mundësisë, qerasen me pije të ëmbla, dominon rakija e Mokrës.

-Familjet me emra e familje të mëdha, sidomos për fëmijën e parë djalë qëllonin tre herë me pushkë.

Ky është një gëzim më shumë për të moshuarit sidomos gjyshit e gjyshet sepse, me lindjen e djalit sigurohet dhe realizohet ëndërra tyre se:

a-sigurohesh vazhdimia gjenetike e gjakut, fisit.

b-ekonomia siguronte vazhdimsi se shtohet një mashkull

c-atdheut i rritej siguria se kishte një

ushtar më tepër.

Pas lindjes mund të organizohet cermoni e vogël familjare.

Në këto raste gatuhet bukë vala me miell misri ose gruri shumë të hollë, hidhet në tepsi e përzier me pak kripë e gjalpë, piqesh me saç në ngjyrën e kuqe të errët. Thërmohet me dorë ose me thikë në forma të vogla në tepsi bakri, pastaj hidhesh sherbet sheqeri për ta embësuar pak dhe jo shumë e butë.

III VENDOSJA EMRIT (NAVIGJE)

Pas disa ditësh të lindjes së fëmijës organizohet një cermoni e vogël dhe e bukur familjare. Organizohet dhe përgjithet vendosja e emrit të fëmijës së lindur. Kjo cermoni quhet navigje. Emrin e zgjedh gjyshi ose gjyshja duke marrë pëlqimin e prindërve në të dy palët e çiftit.

Të afërmit sjellin petulla të vogla, embësira dhe me forma të ndryshme. Në gostinë e organizuar ftohen miqesia e të afërmit të tjerë të rëndësishëm, me ngrënie, dhe me pije e cila mund të zgjase deri në daljen e dritës. Para ngritjes së sofrës sillen fëmija e lidhur lyrek, kopanec nga e jëmë e djalit ose halla, rrotullohet mbi sofrën e cila ka vetëm lugë dhe bukë, më pas në sofër vendoset tepsia e bakrit e kallaisur, dhe e mbushur me copat bukë vale ose kulace të vogla. Secili merr nga një copë për të ngënë dhe hedhur dhuratë ose lekë në tepsi. (vijon)